



UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës  
Nr. 02-54/15-07  
Prishtinë, më 21 qershor 2007  
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Bislim Hoti**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 71 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 13 majit, 1 dhe 4 qershorit 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e kryeministrit, Ethem Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin dhe
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim.

Në fillim të seancës, **kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit, e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, Grupi Parlamentar për Integrim ka parashtruar ndonjë mocion me shkrim për plotësimin e tij me pikën shtesë: “ Tejkalmimi i kompetencave nga ana e Ekipit të Unitetit”.

Deputeti **Ferid Agani** e arsyetoi kërkesën e Grupit Parlamentar për Integrim.

**Kryetari** e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar për Integrim. Por, Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi kërkesën e këtij grupi.

Komisioni Parlamentar për Bujqësi dhe ai për Shëndetësi kishin kërkuar të hiqet nga rendi i ditës pika e tetë: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin.

**Kryetari** e hodhi në votim propozimin e këtyre komisioneve. Kuvendi me shumicë votash miratoi kërkesën e komisioneve për heqjen e pikës së tetë nga rendi i ditës.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese kishte kërkuar që Kuvendi në këtë seancë ta shqyrtojë edhe propozimin për ndryshimin e Rregullave të procedurës për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij.

**Kryetari** e hodhi në votim propozimin e Komisionit Legjislativ.

Kuvendi me shumicë votash miratoi kërkesën e këtij komisioni që rendit të ditës së kësaj seance t'i shtohet edhe pika: Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin e Rregullave të procedurës për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij.

## **2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 31 majit, të 1 dhe 4 qershorit 2007**

Procesverbali i seancës plenare të 31 majit, të 1 dhe 4 qershorit 2007 u miratua me vërejtjen e deputetit **Fehmi Mujota**, që e kishte informuar Kuvendin për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësia natyrore në komunën e **Shtimes**, kurse në procesverbal ishte evidencuar gabimisht “ në komunën e Shtërpcës”.

## **3. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i kishte parashtruar dy pyetje zëvendëskryeministrit të Kosovës, z. **Lutfi Haziri**, por ai nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja **Gjylnaze Sylja** i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me veprimet e kësaj ministrie për parandalimin e sëmundjes së rriqrave.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetes Sylja.

Deputetja **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku** i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me formimin e Këshillit profesional për ndarjen e specializimeve për kuadrot shëndetësore.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetes Kollçaku.